

INTERVISTË ME ZANA NIXHËN

Prishtinë | Data: Tetor 2017

Kohëzgjatja: 58 minuta

Të pranishëm:

- Zana Nixha (E intervistuar)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Prezantoje vetën edhe domethonë emrin, mbiemrin, datën e lindjes edhe tregona pak për kujtimet e tua të hershme të fëmënisë, për familjen tonde, prapavijën e familjes, çka t’kujtohet domethonë prej jetës shumë t’hershme. Cilat janë kujtimet e tua t’para?

Zana Nixha: Okej. Unë... Zana Nixha, Osaj tash. Kom lindë në nëntor të 1978-tës, në Prishtinë. Jam fëmijë i dy arkitektëve, domethonë edhe nana edhe baba kanë qenë arkitektë. Çka muj me mbajtë n’mend prej fëmënisë? Ndosha fëmëninë e hershme ka qenë shumë... domethanë maj n’mend mjaft shumë sepse kemi, ka qenë dëshira e prindërve me shëtitë shumë, me pa shumë.

Ata ndoshta edhe arkitektë, kanë pasë shumë dëshirë edhe kom shumë kujtime ndoshta memorie fotografike shumë t’hershme prej vendeve të ndyshme. Bile mbaj n’mend... ndoshta memorien ma të hershme fotografike e kom dika në Turqi, osht’ ai kali i Trojës, replika edhe unë i kom pasë vetëm tri vjet edhe diçka m’ka metë n’kujtim. Njihërë mendojsha që vetëm prej fotografive, po në fotografi nuk janë ato kujtimet fotografike që i kom unë, t’u hypë n’shkallë, t’u hy mrenda. Domthonë osht’ ni përjetim ndoshta që, ndoshta më i hershëm që e mbaj n’mend. Po, krejt këto m’duket që kanë ndiku mandej në... edhe une me pasë dëshirë me shëtitë me pa...

S’po di, gjithmonë... çka muj me thanë për fëmëninë? Ka qenë e asaj kohë, shkollimi deri... njejtë domethonë, shoqnia në afërsi. S’po di çka kisha mujtë me veçu ndoshta për fëmëni. Kom jetu me gjyshat, edhe ata kanë pasë ndikim ndosha mjaft në formim timin. Po besoj qe sidomos prindët domethonë me gjithë profesionin edhe gjithë dëshirat e tyne kanë ndiku ndoshta ma së shumti te unë.

Aurela Kadriu: Në cilën lagje jeni rritë?

Zana Nixha: Në Dardani.

Aurela Kadriu: A e kujtoni, a e kujtoni jetën n’lagjen e juv në qat’ domethonë kohë?

Zana Nixha: Po. Po, po ka qenë bash si të gjithë qysh e përshkrujnë tash atë kohën. Tërë kohën jashtë, tërë kohën me lujtë, domethonë *hop* pas shkollës gjithmonë u dashtë me dalë jashtë, me gjithë ato

lojna që i kemi lujtë deri vonë n'mramje. Domethonë detyra e të gjitha ato po prapë ki dalë. Domethonë ka qenë qajo periudhë që ndoshta kënaqësia e vetme ka qenë m'u taku me shokë, sidomos në afërsi, n'lagje edhe... lojë tërë ditën.

Aurela Kadriu: A na flet pak për periudhën e shkollës fillore, qysh e mbanë n'mend shkollën fillore?

Zana Nixha: S'po di, shkollën fillore... unë si fëmijë kom qenë shumë e tërhekun, megjithatë gjithmonë kom pasë shumë shoqni. Nuk e di si, edhe sot nuk e di me e spjegju. Po, s'po di, kemi qenë një shoqni shumë e mirë deri diku në klasë të pestë ose të gjashtë. Mandej kanë fillu ajo koha e ndamjës të shkollës, përrjashtimi i disa arsimtarëve që kanë qenë pak ma aktivista, si për shembull [Naxhije Buçinca](#), që tani osht' aktiviste e grave e tjerë. Edhe na domethonë, une e maj n'mend veten prej klasës të pestë që na kemi dalë në protestë (buzëqeshë) kemi kërku me na u, me na u kthy arsimtarët që i kemi pasë, që na kanë largu.

Ndamja e shkollës, ndamja fizike e shkollës domethonë ndamja me mure. Pjesës ku duhet me ndejtë shqiptarët edhe domethonë pjesën ku ki ecë ti nëpër korridore n'skollë, kanë fillu me dalë muret t'cilat pjesë ti nuk mundesh me kalu. Po, nuk e di, ndoshta kjo na ka bo pak ma shumë me qenë edhe ma t'afërt njoni me tjetrin edhe ma m'u ndi... me pasë dëshirë me qenë për njëri-tjetrin, me bo ma shumë. S'i kemi pasë këto problemet e sotshme, me e ngacmu njoni-tjetrin ose me... ndoshta ka ndodhë, po jo tani si janë problemet e fëmive, ndoshta, besoj që qajo periudhë, qajo situatë ka ndiku që na me qenë të tillë.

Aurela Kadriu: A e mban n'mend kontaktin e parë me... e përmendët ndarjen fizike të shkollës, kontaktin e parë me... kur ka ndodhë dhe qysh, qysh është, qysh e kujton ti?

Zana Nixha: Nuk e... s'po di, kemi qenë, disi e kemi kuptu çka po ndodhë. Nuk u dukë, si me thonë, befasi ose a din, me pa, "Uau! Çka ka ndodhë?" Disi jemi përgaditë, ndoshta ke pasë biseda n'shpi që diçka nuk osht' në rregull ose i ke ndëgju prindët, ose ke pase pritje të tilla që ka me ndodhë diçka qashtu, që ka m'u nda. E maj n'men periudhën kur një kohë dy-tre muj s'kemi pasë as mësim, para krejt kësaj domethonë. Diku... mësimi fillojke në shtator na u dashtë klasën e pestë ose të gjashtë me fillu në nëntor apo dhjetor sepse s'e dishim a po na lajnë me hi në shkollë. Domethonë kur ke shku e ki pa, faktikisht nuk ki mbetë shumë i befasum, e ki pritë.

Në anën tjetër ndonji herë t'ka ra me pa ndonji fëmijë që osht' i nacionalitetit serb edhe ai t'ka folë ndoshta. Unë e mbaj n'mend dikun që m'folë shqip sepse kanë pasë vazhdu deri vonë me mësu shqip. Neve serbishtën mandena, na e fillumë ma herët e ata... u mendojshim na domethonë ata arsimtarët e gjuhës serbe jo pak u rebelojshim, pak nuk dojshim m'i ndëgju e tjerë. Po frika ekzistojke, domethonë në ni masë, nuk kemi guxu edhe qaq shumë bash çka (buzëqeshë) si jemi ndi m'u shprehë.

Aurela Kadriu: Para kësaj ndarjes qysh ka qenë kontakti juv me, me njerëzit e nacionalitetit serb? Qoftë kojshi, qoftë fëmijë që keni lujtë n'lagje.

Zana Nixha: Unë jom një fëmijë qe s'kom pasë shumë kontakt, në lagje s'kemi pasë shumë për dallim prej krejt shoqnisë teme qe ndoshta e kanë folë gjuhën serbe se kanë pasë shoqni... une shumë vonë, ma vonë mandej m'ka ra, gjuhën serbe për shembull e kom mësu me, prej televizionit edhe prej

gazetave, s'kom pasë kontakt. Po, nuk e di, nuk kom pasë noj paragjykim edhe noj mendim që, që nuk jonë, që jonë ndryshe ose, ose diçka sepse ndoshta në familje gjithmonë osht' diskutu që osht' problemi krejt ma naltë jo tek njerëzit, mes njerëzve. Nuk e di...

Aurela Kadriu: Si e kanë transmetu prindët te ju krejt situatën? Ose ju te prindët mandej kur e keni pa ndarjen n'shollë edhe...

Zana Nixha: Të them të drejtën...

Aurela Kadriu: A e mban n'mend narracionin e tregimit të prindëve, diskursin?

Zana Nixha: Të them të drejtën nuk di edhe a e kemi përmend, a din se bash s'më kujtohet që e kom tregu si, "Wow, e kanë nda". Ose diçka, se m'duket veç jonë, krejt këto kanë qenë pritje. Noshta kanë qenë ma shumë diskutimi për shembull që na i kanë përjashtu kujdestarën, që nuk po i kthejnë, që na dilshim n'protesta e prindët na kërkojshin, "Ku jeni, çka po boni?" Se domethonë ishim n'klasë të pestë, ishim shumë të vegjël kur bojshëm gjana të tilla. Po asnjihere nuk kanë qenë edhe ata me noj frikë të madhe qe s'bon ose bon ose... "Ku jonë tjerët edhe ti". Domethoë nuk ka pasë noj... për ne, ne...

Tani çka po m'kujtohet osht' si prindët arktiktektë që i kom pasë, i kom pa gjithmonë projektet e tyne si bohën edhe une mbaj n'mend që n'atë kohë kom bo projekte të shkollës qysh kisha pasë qef unë me qenë. Ndoshta kom dëgju prej tyne, po e kom marrë e kom vizatu si vizatohen planet edhe e di që i kom nda shkollat sipas andrrës që i kisha, me laboratorë e me tjera, e me tjera. Ndoshta ajo ka qenë një manifestim që ndoshta diçka që s'kom e që kish qenë mirë me pasë. Po ato e pata mshefë aq mirë, mos me pa prindët se kisha frikë çka po m'thojnë, si, a e kom bo mirë a jo. S'kisha qef me m'pa... n'fakt kur e patën gjetë e di që kom marrë shumë lavdata, "Wow!" A din, "Qysh paske ditë me bo këtë projekt?" Po une mendoj që qajo mungesë ndoshta u manifestu n'qat mënyrë. Atë, domethonë, dëshprimin tim që nuk e kom ose me gjithë ato pengesa e kom shprehë n'qat mënyrë. Nuk e di...

Aurela Kadriu: Mandej... shkolla e mesme, domethonë qaj tranzicioni...

Zana Nixha: Tani shkolla e mesme... shumica nuk kanë qenë në objekt shkollor edhe gjenerata jeme domethonë edhe '78-tës me gjithë tjerët e kemi zgedhë shkollën n'bazë të faktit cili ka objekt. Edhe "Xhevdet Doda" ka qenë ajo që ka pasë akoma objektin e vet, edhe as s'e kemi mendu. Disa thojshin që ndoshta osht' shkollë speciale, matematikore, "A je e sigurtë që don me shku?" Po, nuk e kishim të randsishme edhe qaq veç me shku me një shkollë, ku osht' shkollë, t'paktën unë edhe shoqet e mija që ishim bashkë n'shollë. Mandej ajo u kthy n'shollë të përgjithshme, edhepse shkolla ka qenë edhe ma, në gjendje edhe ma t'keqe se noshta shkolla fillore. Domthonë, ka qenë ni objekt që s'i përngjante shkollës fare dhe tepër i vjetër. Po prapë ishim t'lumtur që ishim në një objekt shkollor. U ndijke njifarë fryme pak që je në klasë.

Aurela Kadriu: E aty qysh e mban n'mend, po mendoj mënyrën e ligjërimit të profesorëve a ka pasë... Çfarë ngjyrimesh ka pasë n'ligjerimet e profesorëve në shkollë të mesme?

Zana Nixha: Ka pasë shumë të ngarkumë me politikë, maj n'mend... shumë, po mendoj ka pasë disa që kanë qenë shumë t'ngarkumë. Bile jemi tallë gjithmonë se disa profesorë na kanë qujtë, kur dojshin, kur bojshim diçka keq ose noj diçka, ton kohën na kanë lidhë jo UDB-a, jo serbët, jo... edhe tonë kohën e kanë lidhë me diçka politike edhe na gjithë kemi qeshë edhe e kemi marrë si tallje, se na jemi të UDB-së, na jemi kështu, na bojmë sende të kqija. Po ka pasë tepër që kanë qenë të ngarkumë. Edhe maj n'mend edhe ma vonë mandej n'kulm të shkollës diku ka viti i katërt e patën shkru "UÇK", shkolla e patë ngjyrosë n'kulm. Që edhe ajo, edhe pse na ishim asi... m'u pat dukë pak e panevojshme se jemi megjithatë shkollë, s'kemi nevojë me mbajtë anë, këndeje ose andej n'kohën, kjo ndoshta ma vonë, n'kohën kur veç u nda mandej kjo Lëvizja Paqësore me Lëvizje të Armatosur. Po ka pasë ndikim, mjaft kanë qenë t'ngarkumë, ka pasë profesora t'ngarkumë...

Aurela Kadriu: A e mbani n'mend qysh ka ndodhë inkuadrimi yt te "Post-pesimistat"?

Zana Nixha: Në fakt edhe ma herët pata fillu me shku nëpër... për shembull e mbaj n'mend që ka pasë ndikim shumë t'madh, ndoshta po filloj prej aty, një takim që e bojshim bisedë me Ilir Rodiqi oragnizojke, oranizojke në kishë, një herë në javë.... Kjo ka qenë n'klasë të tetë edhe bojshim biseda për tema t'ndryshme. M' duket se ka qenë ajo dëshira me marrë pjesë, me bo diçka jashtë shkollës, diçka ma interesante, ma tërheqëse për atë kohë. Krejt kjo nga mungesa që ndoshta e ndiejshë që nuk ki shumë çka me bo atë kohë.

Mandej në shkollë, m' duket që kom qenë në vit të parë, 15 vjet ose nuk e di, e di që dikush, domethonë njeni-tjetrin, "Osht' një oragnizim, osht' i të rive". M' duket që ndoshta joshja ka qenë ajo që dalin jashtë, mbajnë seminare nëpër vende t'ndryshme, organizatë e t'rive edhe "A po vjen me marrë pjesë n'mledhje, në takim me pa çka po ndodhë?" Edhe qashtu, domethonë bashkë me nja dy shoqe që i kom pasë t'klasës, kemi shku edhe kemi marrë pjesë n'takimin e parë.

Aurela Kadriu: Edhe qysh e kujtoni mandej periudhën te "Post-pesimistat"? Ndoshta qato kujtimet e para prej kur keni shku n'ditën e parë prej kur keni shku, ku jonë majtë mledhjet e...

Zana Nixha: Mledhjet jonë mbajtë nëpër shtëpi...

Aurela Kadriu: Çka osht' folë nëpër qato mledhje?

Zana Nixha: Nëpër shtëpia, krye... m' duket Petriti ka qenë ai i pari, [Petrit Selimi](#), i pari që na patë informu në fakt se çka jonë planet, çka ka me ndodhë, çka osht' qëllimi edhe krejt ashtu e mbaj n'mend. Domethonë kemi qenë një grup që m' duket ata që kemi qenë aty kemi mbetë. Fillimisht organizojke një takim në Austri, normalisht që nuk mujshim me marrë pjesë të gjithë, po domethonë kjo ka qenë për atë, m'u përgjaditë. E mandej kanë lindë idetë tjera.

Po pak a shumë krejt ishim ftyra që njiheshim mes veti, ishim shumica prej "Xhevdet Dodës". S'po m' kujtohet kush ka qenë dikush jashtë n'atë kohë, edhepse nuk ishim n'klasë edhepse nuk isha shoqe që rri dit' e nat' me ta, megjithatë ishin aty. Domethonë të ri të njejtës shkollë edhe fillumë, e lamë takimin javën tjetër për këtë, javën tjetër për atë edhe kështu filloi. Ndoshta me t'tregu për përjetimin, nuk e di, për mu ishte interesant me pa çka, çka me ndodhë. Po ish edhe ajo shtytja që kisha dëshirë

me u marrë më diçka pak ma interesant jashtë shkollës normalisht, diçka që m'tërhekë, që mundet me qenë argëtuese, por pse jo edhe me mësu diçka.

Aurela Kadriu: Cilat kanë qenë aktivitetet kryesore me të cilat... të cilat i keni oragnizu n'kuadër të "Post-pesimistave"?

Zana Nixha: Mandej domethonë kur u themelu edhe zyrja, marrëm domethonë donacion, si donacion, si financim prej qeverisë Norvegjeze, atëherë veç fillumë me planifiku shumë ma detajisht. Përveç zyrës, organizimit, ka pasë edhe strukturë, osht' dashtë me e themelu organizatën. Bile maj n'mend në qat kohë une kom mësu çka o statuti, çka osht' (qeshë) organizimi. Gazeta ka qenë një prej idejave, gazeta që me e publiku një gazetë me probleme të rijve, sepse mendojshim që s'ka diçka që na adresohet bash gjeneratës tonë.

Po mandej edhe shumë projekte tjera. Varësisht ka mujtë kushdo me ardhë me ni projekt, edhe me kërku financim prej nesh. Na e kemi shqyrtu, po osht' për ksi, edhe kryesisht merrshim kulturë ose... Por edhe për argëtim, domethanë krejt ajo që na mungojke n'atë kohë, jemi mundu me e bo nëpërmes të "Post-pesimistave".

Aurela Kadriu: Çfare ka qenë natyra e shkrimeve që i bojshit n'këtë gazetën?

Zana Nixha: (Buzëqeshë) Shkrimet, ajo ka qenë, në fillim ka qenë sfidë se nuk dishim. Secili, dikush bojke naj përkthim prej naj artikulli tjetër ose dikush shkrujke. Po ka pasë edhe të tillë edhe që kanë shkru për shembull, jonë ngjarje të vërteta edhe ishim pak të papërvojë n'këtë aspekt. Mandej kur u angazhumë, u bëmë si pjesë e Kohës, "Koha Javore" ka qenë n'atë kohë, si pjesë e saj mandej u angazhunë mjaft edhe ata të "Kohës" me na ndihmu n'këtë aspekt. Edhe e mbaj n'mend shumë mirë, ka qenë Dukagjin Gorani, m'duket Batoni Haxhiu e... ata e kanë pasë si detyrim, ndoshta edhe dëshirë me ardhë me na tregu se si duhet me u ba gazeta.

Prej tyne nashta kemi mësu që, me pasë atë fokusin, me pasë një temë t'caktume, m'u sillë secili artikull rreth temës, me qenë shumë të vërtetë në çdo gjë që shkrujmë deri te ballina, duhet me u lidhë. Domethonë kish që u merrshin me thymje t'gazetës, me artikuj por kish edhe që u merrshin me marketing se megjithatë ni financim u duhke m'u bo për, për, për atë gazetë. Edhe na nuk dojshim prej fondit, jemi mundu me kursy mjaft fondin për gjëra tjera kështu që kemi lypë, kërku prej dona... sponzorëve reklama e këto. Domethonë, ka pasë edhe disa të ndamë që kanë punu me gjetë sponzor.

Por edhe ajo mandej u bo, domethonë me gjetë sponzorë të, diçka që lidhet me t'rijtë. Domethonë nëse osht' naj butik i teshave të rinjëve ose diçka, domethonë krejt atë mësim qysh duhet me qenë gazeta ndoshta e kemi marrë prej, fillimisht prej gazetarëve të "Kohës".

Aurela Kadriu: Mandej këtë, a e mban n'mend... qysh i kujton qato aktivitet tjera që po thu, "kulturore"? Çka kanë qenë këto aktivitete, qysh i keni organizu edhe ku i keni organizu?

Zana Nixha: Ka pasë për shembull kërkesë për ekspozitë personale, por kushti ka qenë, ai që ekspozon, artisti me qenë i ri. Ose ka pasë kërkesë për oragnizime t'ndejave prej tjetër kujt na i kemi financu, po gjithmonë ka qenë me naj temë, ose me, me, me diçka. Këto i mbaj n'mend, nuk e di çka

ka mujtë me pasë tjetër, krejt n'këtë aspekt, domethonë kryesisht kulturë diçka ose koncert me naj bend ose kjo nuk ka pa... këto kanë qenë ato që jemi mundu me i bo, u dashtë me u organizu edhe për takimet e radhës se gjithmonë jonë majtë, m'duket çdo vjet.

Jonë majtë takimet, kontaktet me kta... Ni kohë une jom dashtë me qenë, për shembull m'patën zgjedhë udhëheqëse të zyrës, e mbaj n'mend. U dashtë me raportu për çfarëdo aktiviteti që kemi bo, për fondet ku po i shpenzojmë edhe si po i shpenzojmë. Jemi dashtë me u kujdesë që me 15 vjet që me shpenzu fondin gjatë vitit mos me na mbetë, për fund, për vitin e ardhshëm. Domethonë ka qenë një angazhim për, tani kur e mendoj për 15 vjeçar mjaft i madh. Mandej ka qenë edhe dilemë se cilin projekt, ti e ke marrë faktikisht njëfarë roli me vlerësu financimin sa... por atë e kemi bo bashkarisht, gjithmonë, nuk ka qenë dikush.

I kemi marrë projektin e kemi pa qe ndoshta kjo e mirë, e keqe, po sa mujmë me kontribu. Kështu e maj n'mend, po çka maj n'mend ma së shumti ndoshta osht' që çdo ditë kemi shku aty. Ajo ka qenë si me dalë tash, me shku n'zyre të "Post-pesimistave" edhe me ndejtë bashkë. E kemi pasë një vend ku jemi ndi mirë, si n'shpi, mas shkollës "Post-pesimistat".

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: A na tregon qysh ka qenë struktura e njerëzve që kanë qenë "Post-pesimista", edhe cilat kanë qenë kriteret me t'cilat njerëzt kanë mujtë me u bo pjesë?

Zana Nixha: Nuk e di që ka pasë kriter, shumica, na ishim t'interesumë, plotë, kushdo që osht' i interesum me punu, me kontribu në cilindo aspekt, me ide, me ide të reja, me, me, sidomos me gazetë. Se me gazetë ka pasë nevojë, domethonë kërkesë ma t'madhe, domethonë kushdo që ka dashtë me u angazhu në këtë drejtim. Edhe di me një moment kur i mbajshim mledhjet, m'duket që javore edhe unë e udhëheqsha mledhjen, ka pasë shumë t'pranishëm edhe ka qenë edhe kordinatorja e zyrës, Violeta, e cila pat ardhë, pat thonë, "Zana, osht' pak rrezik me qenë kaq shumë brenda në zyre". Se domethonë atëherë ka qenë e dyshimtë secila mbledhi, secili tubim aq i madh i njerëzve.

Edhe e di që kom dalë para ni detyre shumë t'vështirë, me ju thonë, "Duhet me dalë". E di që ka qenë dëshpërim po nuk, nuk guxojshim me bo kaq shumë tollovi mrenda edhe me disku. Ish pak si, domethonë, ka mujtë me qenë e rrezikshme me ardhë, "Pse, qysh, tek?" Domethonë u munojshim me evitu këto raste. Ndoshta ka pasë dikush që u ndi keq, ose i përjashtum n'ato momente, por individualisht kur kanë dashtë me ardhë m'u anagazhu nuk besoj që kemi pasë noj kriter të caktum.

Mandej jonë zgjedhë për takime, domethonë për takime kush ka me shku, nëse jonë zgjedhë ta zamë gjashtë vetë me shku në seminar në Norvegji, atëhere ka qenë ajo përzgjedhja pak më e vështirë. Besom s'e mbaj n'mend as pse dikush po, dikush jo, po kryesisht secilit i ka ra. Domethonë nëse këtë vit s'ka mujtë, ata që s'kanë qenë këtë vit, kanë shku vitin e ardhshëm e kështu me radhë. Unë kom qenë për vete dy herë në Norvegji m'ka ra me shku në takime që kanë qenë pak ma vonë, jo n'qat vitin e parë kur jom inkuadru. E kështu, m'duket që s'ka mbetë askush pa...

Aurela Kadriu: Ku i keni pasë zyret?

Zana Nixha: Zyrja ka qenë Strip Depo tani kafiteria, bash ajo banesë. Banesa ka qenë e Petritit, e patëm marrë atë banesë pak edhe... gjeishëm pak forma gjithmonë t'arsyetimit domethonë, osht' e Petritit banesa, nëse ka me pasë problem, gjithmonë pritshim noj polic ose diçka ka me na pytë, "Pse, çka po boni ktu?" ose diçka. Edhepse mandej e patëm, ka qenë e regjistrome, e di që regjistrimi u dashtë m'u bo në Beograd atëhere i zyrës edhe, por edhe me anëtarë serb. Domethonë, "Post-pesimista" të gjitha fondet e këto që i kemi marrë ka qenë jo vetëm si oragnizatë e fëmive shqiptarë po bashkarisht, shqiptarë dhe serb. Edhepse ata i njishim po ata nuk guxonin me ardhë asnjherë në zyre të "Post-pesimistave".

Na e di që patëm marrë si me thonë "bekimin", e di që patëm pytë edhe kastën politike t'asaj kohe nëse, çka mendojnë që na po e hapim një organizatë bashkë me fëmi serb edhe e di që deri dikush, e mbaj n'mend në zyre dikush pat' ardhë pat' thonë, dej edhe me Ibrahim Rugovën kanë bisedu për këtë punë, edhe ai osht' shumë për, "Po, shumë mirë që po e boni këtë aktivitet, duhet me vazhdu me këto". Edhe disi jemi ndi rahat, sidomos këtë anën tonë, por anëtarët serbë kanë pasë, s'kanë guxu faktikisht me ardhë prej njerëzve të tyne.

Aurela Kadriu: Thatë që osht' regjistru në Beograd, a din qysh ka ndodhë procesi, a ke qenë aty?

Zana Nixha: Po, se në qat' kohë dojsha m'u zgjedhë si udhëheqëse, ajo u dashtë m'u shkru statuti, u dashtë m'u dërgu. Nuk e di, une nuk jom marrë...

Aurela Kadriu: Çka me bo?

Zana Nixha: M'u dërgu statusi në Qendrën e Regjistrimeve të Organizatave ose çka po di...

Aurela Kadriu: Në Beograd?

Zana Nixha: M'duket se ka qenë në Beograd, sa e mbaj n'mend une ka qenë në Beograd që u dufke m'u, m'u shqyrtu edhe nuk besoj që kemi pasë problem, nuk kemi pasë problem për, për regjistrim.

Aurela Kadriu: A na tregon pak për përvojën në qytet, qato aktivitet që i keni organizu, që thatë kulturore, a jonë bo nëpër hapësira, me siguri alternative osht'... a na tregon përvojën me qytet në tanësi? Ju keni jetu në Dardani, keni shku në "Xhevdet Dodë", prej "Xhevdet Dodës" keni shku n'zyre në Strip Depo, mandej aktivitetet i keni oragnizu diku tjetër, veç në qoftëse mundesh...

Zana Nixha: Kryesisht kanë qenë si të gjitha, jo vetëm aktivitetet tona po si të gjitha. Çdo ekspozitë që u mbajtë, u mbajtë me naj lokal n'atë kohë edhe ashtu kemi vazhdu ose kanë qenë disa kafiteri për çfarëdo ndeje. M'duket që ka qenë ni diskotekë, ni hapësinë e madhe që na e kemi shfrytëzu, te Pallati i Rinisë. S'po m'kujtohen çfarë vende tjera, këto kanë qenë. A din, domethonë nuk ka pasë naj hapësirë tjetër. Të gjithë e kemi ditë që çdo organizim ka m'u bo nëpër kto vende t'vogla, të adaptume për një aktivitet t'caktumë, domethone s'ki pasë asnj vend diku ku ki mujtë me shfrytëzu që osht' i mirëfillt për ekspozita ose për këto.

Aurela Kadriu: Qysh e bojshi distribuimin e gazetës?

Zana Nixha: Gazeta mandej ka fillu me “Kohën Javore”, u ble me “Kohën”, bashkë me “Kohën”. Nuk m’kujtohet nëse e kemi pasë najhere vet, m’duket që prej fillimit ka qenë me, me “Kohën”. Pat’ bo njifarë emri, të rijtë t’paktën e dishin, u duke interesant. Mandej nëse nuk e kemi angazhu në gazetë, n’ballinë ka pasë lloj-lloj njerëz t’ri prej të gjithë, prej... edhe Prishtina ka qenë e vogël n’atë kohë, shumica jemi njoftë njëri me tjetrin, a din, nuk ka ndodhë me gjetë, me rekrutu, me marrë dikond prej që s’e ki njoftë. Krejt nëse s’ki ndejtë me ta e ki ditë kush jonë. Domethonë kemi qenë njifarë, kushdo që ka dalë n’gazetë m’duket që t’gjithë e kanë njoftë kush osht’ ose pse ose.... Po ka qenë interesant edhe argëtuse sepse t’gjithë ato idea, me siguri i keni pa disa ballina e këto edhe ndoshta ma së shumti argëtuse ka qenë sa do që ka qenë punë. Po...

Aurela Kadriu: Qysh u përceptu kjo prej, pjesmarria e juv domethonë aktiviteti juv tek “Post-pesimistat”, qysh o përceptu prej, prej rrethit, prej familjarëve, prej, në qat’ kohë që nuk ka qenë koxha e lehtë me lëvizë nëpër qytet?

Zana Nixha: Në fakt ata kanë qenë shumë të gëzumë që jemi anagazhu diçka ma të vleshme se sa vetëm me ndejtë kot mas shkollës. E mendojsha ndoshta edhe ata jonë njoftë krejt mes veti, e kanë ditë me kon po rri prindët. Domethonë, jonë ndi t’sigurtë që je në shoqni t’mirë edhe... po mendoj krejt kanë qenë shumë pozitiv edhe shumë, bile e di që ka pasë shoqe që s’kanë qenë t’inkuadrume edhe prindët ju thojshin, “E pse ti jo?” A din, “Pse nuk po inkuadrohesh edhe ti?” Më duket që t’gjithë kanë qenë shumë t’knaqun me qenë pjesë e kësaj.

Nji moment e kom pasë nji... prej prindëve, prej babës konkeretisht, n’momentin kur m’kanë zgjedhë si drejtoreshë a çka po di une, e di qe ai m’ka mbajtë ligjeratë shumë të gjatë diqysh... se i’u pat dukë çudi që ndoshta mu po m’pëlqen me pasë ni pozitë udhëheqëse edhe e di që ma ka majtë ni ligjeratë shumë t’gjatë që, “Nuk osht’ me rëndësi karriga”, (qeshë) prej asaj kohe, “me randësi osht’ profesioni, me randësi çka po bon”. Po mu m’u pat dukë shumë banale se mu veç dikush ka ardhë, “Ou, Zanë a po pranon ti?” Edhe une, “Po”. A din, nuk ka qenë ajo diçka që e kom marrë shumë me...

Po e di që qaty ka qenë ai hezitimi i parë, edhe e di që o dashtë me ardhë me bisedu me koordinatoren e zyrës edhe me pa pse, çka kom me bo, çka jonë detyrat e mija. Njifarë ku po hy, në çfarë, në çfarë... Po pasaj u pa që nuk osht’ kurgjo diçka, po menoj rëndësi shumë t’madhe edhe kaq. Po këta e mbaj n’mend si detaj, bile ia pata kthy ma vonë. Kur ai pat marrë nji pozitë (qeshë) këtu diçka i pata thonë, “Hë, edhe ti për karriga si unë”. Po gjithmonë e kom pasë atë, domethonë atë që ndoshta duhet m’u marrë me profesion edhe me të e jo me, këto tjerat s’janë të randësishme edhe s’jonë të vleshme.

Aurela Kadriu: A na tregon sinkronizimin ose koordinimin e aktivitet me grupet tjera të “Post-pesimistëve” që kanë qenë në Koraci, Bosnje e Serbi?

Zana Nixha: Na gjithë... me grupe tjera, aha që kanë qenë “Post-pesimistat” atje po mendon?

Aurela Kadriu: Po.

Zana Nixha: Na kryesisht vetëm jemi taku nëpër këto takime jashtë. Nuk di që kemi komunikuar shumë. Ndoshta individualisht njëri me tjetrin, domethonë kemi mbajtur noj, noj takim. Po na kemi qenë shumë ma aktiv në çfarëdo projekti që kemi bo këtu. Ndoshta ka qenë qajo vërejtja që na duhet me qenë bashkë me fëmijë serbë këtu e s’kemi komunikuar po disi... asnjëherë s’ka qenë arsyeja pse na nuk po e bojmë.

Atje kemi kalu, ku jemi taku kemi kalu shumë mirë njëri me tjetrin. Po ka qenë shumë e organizuar mirë. Kemi pasë takime t’mëngjesit me psikologë gjithmonë ku disi kemi diskutu bash si ndihemi n’vendet tona po edhe e kemi dëgju tjetrin si ndihet. Edhe e kemi pa që ka shumë t’përbashkëta, ma shumë se sa dallime. Kanë qenë mandej edhe takimet e masditës ku zakonisht mandej jonë, gjithmonë ka mrriri deri te politika dikund kur kemi diskutu për zyret, për komunikimin. Koordinatorët ndërkombëtarë gjithmonë kanë insistu na m’u bo bashkë. Gjithmonë na e kemi tregu pse osht’ vështirë me qenë bashkë në situatë t’tillë, sa osht’ e rrezikshme. Edhe ka rezultu ndonjiherë edhe me akuza edhe me... po vetëm gjatë takimit, si ka kalu ajo mandej ki vazhdu prapë me me t’njejtën pa kurfarë inati ose... kaq sa e mbaj n’mend unë të paktën.

S’po di, na ndoshta jemi ndi ndonjiherë pak ma t’veçumë për shkak t’gjuhës. Ata ndonjiherë mblidheshin, kishin kangët e përbashkëta i dinin t’gjitha, njena me kitare a diçka. E na pak ishim si, se s’i dishim (qeshë) se na i kishim tonat. Edhe këtu e kemi pasë ni kritikë për shembull gjatë qëndrimit në Norvegji që e kemi pasë seminarit që, “Pse ju shqiptarët rrini pak ma t’veçumë?” Nuk ka qenë noj arsye, ka qenë vetëm ajo arsyeja që kishim qef me ndejtë bashkë ose me këndu shqip. Mandej ia patëm nisë, “Okej, a po doni? Hajde po kendojmë edhe shqip, ndëgjoni edhe këtë pjesën tjetër”. Po ata kishin shumë ma t’përbashkëta n’këtë aspekt. A din, ndoshta gjuha edhe...

Aurela Kadriu: Në sa takime t’ka ra me marrë pjesë?

Zana Nixha: Po kjo kryesorja ka qenë një, në Norvegji, mandej patëm shku edhe në një takim tjetër vetëm dy prej këtu. Ka qenë ma shumë për fëmijë refugjatë, po se mandej u bonën edhe “Post-pesimistat” refugjatë në Norvegji që kanë qenë. Domethonë ka pasë shqiparë e boshnjak po kanë shku edhe disa prej secilit vend. Ka qenë takim ma shumë për ata e na ishim si me ju tregu se si bëhet... Mandej kom shku edhe n’takime tjera kudo që kemi gjetë. Ka pasë takime në Suboticë, në Novi Sad, këtu pak ma n’rajon. Nuk m’kujtohet diku tjetër, m’duket që qito jonë.

Aurela Kadriu: A t’kujtohet udhëtimi deri, po flasim deri në Norvegji që o ma larg?

Zana Nixha: Po, shumë mirë maj n’mend. U dashtë me, m’duket që dikund në Cyrih, u takojshim t’gjithë bashkë, deri atje shkojshim ndamas. M’duket që na shkojshim në Beograd me autobus, po. Kemi shku me autobus, ka qenë autobusi në 5:00 në mëngjes, në Beograd grupi jonë mandej u takojke me ata serb m’duket. Mandej u takojshim në Cyrih të gjithë edhe vazhdojshim në, patëm vazhdu në Norvegji. Dy herë që kom qenë, kështu ka qenë m’duket.

Nuk e di, edhe në Beograd e kemi pa që ndoshta prej këtu u duke “Wow, ku po shkon?” Po atje as nuk e dinin as çfarë gjuhe po flet, as kush je, as... po mendoj, nuk e ndijshe vetën diçka keq që ke shku atje. Ka qenë ni kangë, kur dojshim me gjetë ni kangë t’përbashkët që e dijmë t’gjithë, në aeroport bile e di që e bojshim atë grupin. E di që e patëm zgjedhë atë kangën e Branko, ka qenë një emision i

fëmive, t'cilin na e kemi shiku shumë t'shtuneve e t'diellën... E ka qenë ni kangë hyrëse e asaj e hajde, qe këta pe dijmë edhe p'e këndojmë bashkë. Po kemi ndejtë, jemi knaqë bashkë prapë se prapë me gjithë çka ka ndodhë n'mes nesh.

Aurela Kadriu: Çka jonë konë prindët t'u punu gjatë të '90-tave, m'fal që po kthehna...

Zana Nixha: Po. Prindët i patën përjashtu prej punës, ata dytë kanë qenë proefësorë në fakultet të arkitekturës, jonë përjashtu. Mandej jonë munu me gjetë, e maj n'mend n'fillim patëm hapë edhe dyqan bile të pjesëve t'makinës mos gabofsha. Mbaj n'mend babin që shkojke në Greqi me gjithë tjerë që kishin dyqane për këta, me i ble pjesët për m'i shitë këtu. E pse e mbaj n'mend osht' se gjithmonë ku ka shku na ka sjellë edhe ka ni lodër prej Greqisë edhe na pat' bo atë koleksionin e barbive, dhomën e ditës, dhomën e fjetjës (qeshë) e të gjitha. Ato e mbaj n'mend, domethonë unë nuk e kom pasë ndonji përjetim që, "Wow, tani osht' keq". M'u pat' dukë, thjeshtë u dukë normale sepse t'gjithë kalonin nëpër, nëpër këtë periudhë. Të gjithë e kishim problemin e njejtë edhe nuk u ndijshe ti ma keq ose ma...

E di qysh, për shembull ka pasë kohë kur kanë thonë, "S'muj me shku në pushim". Ka pasë vit, n'qato vite, "S'muj me shku në pushim". Ka qenë shume normale, shumica s'kanë shku në pushim. Domethonë nuk je ndi që po ki ma pak ose po je ma keq ose diçka sepse t'gjithë kemi qenë njejtë. Qeshtu e maj n'mend këtë pjesë. Mandej, babi ka shku ka punu në Shqipëri një kohë t'gjatë, në Tiranë, si arkitekt mandej iu pata bashkëkangjitet edhe unë në vitin e fundit, une me gjithë familjen. Edhe atje kom jetu ni vjet në Tiranë.

Aurela Kadriu: Në cilin vit?

Zana Nixha: '96. Në vitin '96 unë kom shku n'shkollë t'mesme, vitin e katërt në "Sami Frashër" në Tiranë.

Aurela Kadriu: A na tregon pak për qat' periudhë?

Zana Nixha: Po...

Aurela Kadriu: Qysh ka ndodhë që keni shku ma s'pari edhe periudhën atje?

Zana Nixha: Tani mu s'më ka ra shumë gjatë n'shkollë sepse.... Kështu, babi ka qenë ni kohë t'gjatë atje edhe dikur vendosëm që na duhet me qenë bashkë, nuk mundemi me jetu të ndamë. Plus mendonim që ndoshta perspektiva për mandej për studime, për këto, për ne osht' shumë ma mirë me qenë atje se sa në Kosovë. Edhe nana mujke m'u inkuadru me punu në profesion t'vetin atje, në Kosovë nuk, nuk kishim mundësi. Kështu që vendosëm të gjithë me shku atje. Sado që deri atëherë kemi shku nëpër festa, nëpër këto për shkak që ka qenë ai atje. Por këtë herë vendosëm t'gjithë me shku edhe m'u inkuadru në shkollë, secila, unë, motra, vllau në kopsht e tjerë.

Unë kom shku me ni, s'po di si me thanë, me, ndoshta edhe "Post-pesimistat" m'kanë ndihmu, mos me shku me paragjykim, me qenë i hapun edhe me pranu me qenë pjesë e tyne. Domethanë, se shumica që shkonin atje e kishin njëfarë, "Ata kshtu, ata ndryshe, ata s'dijnë, ata flasin..." Jo, edhe kom shku me një shumë entuziazëm n'fakt. Sepse atje ish një jetë pak ma ndryshe, atje shkojshe në

teatër (buzëqeshë) shumë ma shpesh, ose kish koncerte gati tonë kohën. Edhe e di që mas shkollës gjithmonë me shokët e klasës, me shokët e klasës n'fakt meniherë fillova me ndejtë edhe e di që kanë ardhë m'kanë thanë, "Zanë, ti ndryshe prej kosovarëve". Unë thom, "Pse?" "Po pse ti nuk na tregon sa ma mirë, sa ma shumë dini ju se sa na". E kishin edhe ata një ndjenjë të inferioritetit noshta, se na kemi qenë gjithmonë ma t'hapur ndaj perëndimit e këto.

Jo, mu n'fakt m'u ka dukë shume interesant edhe fakti që ta zamë shokët e klasës nuk t'pysnin, "A je t'u lexu naj libër?" Por t'pysnin, "Cilin libër je t'u e lexu?" Edhe gjithë e kom cekë këto, se atje t'gjithë lexonin shumë, t'gjithë kishin njohuri të përgjithshme shumë ma, bajagi ma t'gjanë se sa shumica e nxansëve ose t'rijve këtu. Kështu që, kom kriju një shoqni shumë shpejtë edhe kemi shku nëpër ekskurzione bashkë edhe akoma i kom shokët që i kom pasë atje. Edhepse për një periudhë shumë të shkurtë, se '97-tën fillunë trazirat atje pastaj edhe u deshtë prapë m'u bajtë në Kosovë. Po m'ka mbetë për ato gjatë, sa mujë, katër-pesë mujë, mu m'ka mbetë shoqnia deri sot. Me, jemi dashtë n'fakt me marrë mësim shtesë për me i zanë. Atje i kanë pasë dy matematika, kom pasë, gjithmonë kemi pasë mësim shtesë.

Muj me veçu një moment kur për shembull profesoresha e matematikës nuk dojke me m'pytë fare. Atje pyteshim gati çdo orë me rend, i kishim ka dhjetë, pesembëdhjetë nota në gjysemvjetor, dhe vetëm mu m'kalojke. Profesori i cili unë kom ushtru matematikë e di që thotë, "Pse s'po të pytë?" "Nuk e di". Edhe pat, pat shku pat folë me ata edhe i pat thonë, "Pyte, s'ka dert". Tha, "Po kom frikë, se noshta s'din". E kish, ish një paragjykim që, e tha, "E qes keq, mendej s'kom çka i boj". Thotë, "Jo, jo, pyte". Edhe kur m'pytë une i disha se kisha mësu bajagi, ma shumë se krejt edhe mandej e di që ajo para t'gjithëve thotë, "Duhna me t'kërku falje, se kjo ka qenë një paragjykim që ju të Kosovës kur vini nuk dini. E m'vjen keq". Edhe e di që edhepse ka qenë ashtu e rreptë, të gjithë ju kemi pasë frikë e di që aty pat, pat kërku falje për paragjykimin që e ka për nxansat kosovarë (qeshë) t'asaj kohe.

Kështu që, kom kalu mirë, sidomos kujdestarja e gjuhës shqipe, ajo mu, edhe Garentina [Kraja] ka qenë në t'njejtën kohë në Shqipni, gjithmonë na ka afriu, na ka marrë nëpër krejt takimet, gjithë na ka zgjedhë n'mesin e nxansëve. Nëpër takime me shkrimtarë t'mdhej, ka qenë Ismail Kadare ose Azem Shkreli. Azem Shkreli n'fakt pat organizu edhe Garentina. Domethonë, gjithmonë kemi qenë na të përkëdhelurat që, sepse ka pasë dëshirë me na, me na afriu edhe me qenë pjesë e tyne. Une kom përvojë shumë, shumë pozitive, shumë t'mirë në Shqipni.

Aurela Kadriu: Ke qenë aktive në "Postpesimista" kur ke shku...

Zana Nixha: Jo. Jo...

Aurela Kadriu: A po atëherë veç...

Zana Nixha: Jo, jo vetëm kom dalë. Nuk e mbaj n'mend pse, m'duket kanë qenë edhe disa mosmarrëveshje që m'kanë ba me dalë po kanë qenë të zakonshme. Domethonë unë s'u pajtojsa me një mënyrë t'organizimt, ata donin m'i organizu disa *workshope* [punëtori] mrenda, une isha për me i marrë prej jashtë me i organizu dikush, me i udhëheqë ato. E di qe shokët mes veti kemi pasë edhe momente të mosmarrëveshjes edhe unë me një moment kom thonë, "S'po pajtohna mo me krejt

këta”. Edhe kom vazhdu, po mendoj kom dalë po edhe i kisha interesimin tjetër. Besoj që qajo ka qenë ma shumë arsyeja.

Aurela Kadriu: A e man n’mend, qysh e mban n’mend qat’ peridhën kur jeni kthy prej Tiranës në ‘97-tën në Kosovë? Qat’ përvojën kur je kthy?

Zana Nixha: Po. U ndërpre mësimi në Tiranë për shkak që fillunë trazirat diku ka jugu i Shqipërisë edhe na pritshim kur po fillon mësimi, por nana... nana mbajke hala mësim në fakultet si mësim bllok, sepse nuk e patën lëshu krejt fakultetin, majshin mësim që mos me lanë mangut në Universitet të Prishtinës. Ajo veç u pat’ kthy ma heret puna e mësimi. E pat marrë edhe motren e vllaun m’duket me veti, jo vllaun. E une mandej meta thashë, “Sa rri kot, hajt po shkoj në Prishtinë rri”. Ajo ka qenë vetëm po i kom hypë autobusit, po shkoj deri sa të fillon mësimi edhe kthehem. Edhe s’jom kthy ma.

Baba mandej kur ka dalë e ka pasë shumë të vështirë me dalë prej, prej... Po domethonë vetëm fati, kom dalë n’momentin e, thjeshtë me ardhë n’shkollë me i pa shokët e klasës që i kom pasë ktu. Me ndejtë se s’kom pasë msim, kshtu... Mandej e kom pasë vështirë me u inkuadru n’shkollë ktu, t’njejtën shkollë që kom qenë tri vjet. E di që kanë bo shumë problem, jo duhesh me hi me provime klasore, s’mi pranojshin notat e gjysëmvetorit atje. Ajo ka qenë dëshpërimi im i madh ndoshta, se n’shkollën t’cilën unë kam qenë tri vjet po pritem pak ma keq se sa n’shkollën që shkova atje s’më njifke askush.

Muj me bo përjashtime, ka pasë profesorë që kanë, jonë mundu shumë dhe m’kanë pytë edhe t’gjitha po ka pasë disa tjetër që jo. Kshtu që une kom pasë nota n’disa landë masi n’landë tjera jom dashtë me hy n’provime klasore. Nuk e di.

Aurela Kadriu: Manej, çka, çka keni vazhdu, qysh keni vazhdu mbas shkollës t’mesme? Çka ka ndodhë mas shkollës t’mesme me juve?

Zana Nixha: Jom regjistru në fakulltet edhe kur jom regjistru në fakulltet...

Aurela Kadriu: N’cilin vit?

Zana Nixha: Ka qenë ‘97-ta. ‘97-ta, dita e parë e fakulltetit kanë qenë protestat e 1 tetorit (qeshë). Domethanë dita që u dashtë me shku n’fakulltet për ditë t’parë ka qenë n’protesta. Kanë qenë...

Aurela Kadriu: A keni dalë nëpër protesta?

Zana Nixha: Po.

Aurela Kadriu: Qysh i mban n’mend?

Zana Nixha: N’fillim kanë qenë shumë frikshëm megjithëse shumica e kishim, e nishm si obligim nuk ka shanca as me mendu mos me dalë. Po mendoj, pritshim gjithçka, prap se prap kemi dalë nuk, ka qenë frika po ka qenë si obligim, “Duhet edhe nuk ka çka aty”. Edhe 1 tetorin e mbaj n’mend shumë mirë, e di që kemi ikë prej, kur kanë fillu mandej me, me, me kto. Ka qenë bajagi e frikmshe, kemi ndejtë nëpër shpija deri sa ka përfundu, deri n’mramje dikund t’u u strehu nëpër kto, shpijat deri sa kinse u largu rreziku.

E mandej ka pasë protesta edhe ma shpesh, dikur ja nisën mu bo ma t'shpeshta edhe nuk kish ma reagim qaq t'madh t'policisë sa n'fillim. Po t'gjithat gati jemi dalë. Ka pasë forma t'ndryshme t'protestimit por unë e mbaj n'mend... ka pasë prapë, ka pasë bash në qendër e di, mbaj n'mend kur gjujshin këto {shpjegon me duar} për gaz lotësjiellës. E mbaj n'mend se disi u ulshim {shpjegon me duar} na kalojshin mbi kokë po...

Nuk e di, osht' shumë interesant, tani kur i kujton jonë shumë të frikshme, momentin kur je aty... frikshëm po ish edhe njëfarë s'po di... e zakonshme po mandej edhe e diskutojshim duke qeshë, "Çka na ndodhi, si na ndodhi, ti ku ishe? Çka..." Domethonë, ish njëfarë normaliteti (qeshë) që s'ish dashtë me qenë normal por ja që krijohet domethonë kur, kur e ki t'përditshme.

Aurela Kadriu: A keni qenë pjesë e grupit organizativ të protestave...

Zana Nixha: Jo.

Aurela Kadriu: A veç keni marrë pjesë?

Zana Nixha: Jo, jo. Jo për shkak se na kemi qenë sa u regjistruamë n'fakulltet, na as nuk e dishim, nuk i njihnim kolegët e fakulltetit ta zamë ose... Nuk ishim hala pjesë e asaj. Dita e parë ka qenë protesta e 1 tetorit domethonë... Mandej protestat i organizonin jo vetëm prej, po mendoj ishim organizim pak ma, jo vetëm i studentave sa e di une. Ka pasë lloj-lloj organizmi të protestave në atë kohë. N'fakulltet kemi qenë prap nëpër shpija...

Aurela Kadriu: A na tregon pak për qet' periudhë? Ku i keni mbajtur Fakulteti i Arkitekturës...

Zana Nixha: Në Arbëri ka qenë. Mirë u patën organizu, po mendoj u mbajshin bash me rregull. Na e kishim pak problem sepse Fakultet i Arkitekturës kish ma shumë punime, por pjesa ma e madhe e punës osht' bo n'shpi. Domethonë m'duket se akoma vazhdon me qat' avaz, kryesisht vizatimet, punimet, këto krejt bohen n'shpi. Por nuk ka qenë edhe ndoj kriter shumë ma i ulët. Me siguri ka qenë nëse krahasohem me gjeneratat ma t'vjetra por e di që nuk kanë lëshu pe edhe e di që bajagi kemi punu mjaft, sidomos vitin e parë. Kemi mësu shumë për provime, punimet disa herë jonë kthy, bajagi vështirë jonë vlerësu, domethonë ka pasë një kriter bajagi ma t'naltë. Nuk ka qenë që ka ra kriteri për shkak të kushteve ose situatës, nuk besoj. Ndoshta ka qenë s'ki mujtë me realizu mësimin mirë për shkak të mungesës së hapsinës, po une e di që kemi punu mjaft.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë, koxha larg e ke pasë prej Dardanisë deri në, në Arbëri në qat' kohë, a na tregon pak për, për përvojën e udhëtimit për në fakulltet?

Zana Nixha: Kurrë s'kem shku vet, gjithë kemi qenë bashkë me {shpjegon me duar} me dikond. Jemi knaqë rrugës n'fakt se kemi shetitë, kemi ble diçka me hongër, noj kifle, maj n'mend kifle kemi pasë, me shku naltë. Nuk e di, s'ka qenë diçka... ne jemi dallu pak të arkitekturës, i kemi pasë krejt do çanta t'mdhaja që kemi hecë rrugës. Nuk e kemi pasë frikën që dikush na ndalë ose na thotë, "Pse?" Ndoshta edhe ka mujtë me ndodhë po t'gjithë e kemi ditë që mundet me ndodhë. Po disi ka qenë njëfarë e ditun që ka universitete t'gjuhës shqipe nëpër shtëpi dhe m'duket që një kohë veç u pranu qashtu me u mbajtë. S'e kemi ndi jonë rrezik.

Mandej kemi vazhdu nëpër kafiq “Punto” ose (buzëqeshë) atje te Santea, domethonë shumë normale. Nuk ka qenë diçka që... gjithë e ki pasë një frikë që mundet me ndodhë diçka, por ki jetu me atë edhe t’u ka ba një, nuk ke nisë me ndi vetën ma ndryshe.

Aurela Kadriu: A m’regon mandej për shkëputjen e luftës? Qysh ia kanë nisë trazirat në Prishtinë? Ku jeni konë gjatë luftës?

Zana Nixha: Une n’fakt mandej kom apliku për me shku në studime në Vienë edhe faktikisht unë kom shku në janar të ‘99-tës në Vienë. Ajo lufta filloi, diku bombardimet fillunë në mars a? Në mars me 24. Për mu ka qenë shumë, une e kom pasë, tash fillimin kur shkon jashtë i bon me iks {tregon me duar} secilën ditë kur ki mu kthy n’pushim në Prishtinë. Edhe bash n’kohën kur kom pasë m’u kthy n’pushim fillunë bombardimet. Gjithë familja ish këtu. Për mu ka qenë frikë edhe dita e parë, këtu ditën e parë mujshin me bisedu m’thojshin, “Ou na po festojmë”. Po ka qenë bash kështu traumatike çka ka me ndodhë. Ndoshta edhe kish shumë lajme, kjo, ajo, diskutime që i shihshim.

E mbaj n’mend në konvikt ka qenë dhoma e televizionit, e di që e patëm zaptu na, kush ish i Kosovës edhe aty kemi ndejtë me mujë të tana dit’ e nat’, me pa çka po ndodhë. Ka pasë një periudhë kur nuk e kom ditë hiç ku janë të familjës, s’kom pasë kurfarë kontakti. Dikush thojke kanë dalë, dikush jonë. Ka qenë bash periudhë e vështirë. Nganjëherë shpesh e diskutojmë n’shpi cila ka qenë ma e vështirë, normalisht që ka qenë këtu po nuk ish edhe shumë lehtë mos me ditë ku e ki familjën me javë të tëra.

Shumica ishin prapë ashtu atje, në Vienë ka qenë prapë një komunitet mjaft i madh i studentëve të Kosovës, prapë aty kemi ndejtë bashkë, kemi ngushllu njoni tjetrin, ndihmu. E mbajë n’mend një kohë mandej kur u ndërpre në telefonat, s’mujsha me gjetë, krejt numrat e telefonit m’bijshin në mend t’njerëzve që përreth edhe i kom thirrë kudo që kom mujt me marrë vesh. Ka qenë periudhë, bash muj me thanë e randë, bash periudha ndoshta ma e randa për shkak që s’e din familjen ku e ki.

Aurela Kadriu: A kishin qenë në fakt familja...

Zana Nixha: Familja ka ndejt në Prishtinë gati tanë kohën, dikah pak para përfundimit të bombardimeve ka dalë nana me motrën e me vllaun, babi ka mbetë në fakt. Ka qenë në Prishtinë po s’ka pasë lidhje telefonike, kryesisht jonë bajtë se na i, i kemi pasë pak si, si shtëpi, kanë shku nëpër banesa, ka qenë pak ma të sigurtë, kanë ndejtë kah 20 vetë, 30 me një banesë bashkë, gjithmonë të veshun t’gatshëm për me dalë nëse vijnë me i përjashtu.

N’atë rrugë ku kemi jetu na ka qenë e statcionume ushtria faktikisht, jo paramilitartë e këtu edhe ata nuk i kanë përjashtu prej, prej banesave, prej shpijave kështu që kanë mbetë. Po që ka qenë traumatike, arsya që faktikisht nuk ia din fundin edhe çka ka me ndodhë. Dikur nana vendosë me i marrë edhe me dalë me njëqind mijë vështirësi, dalin në Maqedoni njëherë edhe vazhdojnë në Francë. Në Francë të, kom pasë të familjes por kjo ka qenë në fund dikur dy, tri javët e fundit bon vaki. Unë atje mandej i kom taku prej Vienës, kom shku m’i taku në, në Paris.

Aurela Kadriu: A m’regon për qit’ periudhën qysh, për këtë takim me t’shpijë atje?

Zana Nixha: Nuk e di. S’e, s’e di, nuk e di sa ka qenë, ndoshta ka pasë shumë biseda mandej, tonë kohën kemi komunikuar edhe atje kemi pasë të familjes shumë. S’po di, u gëzuar që pat përfunduar gati, m’duket që pat përfunduar bash n’atë kohë bombardimet mbaroi edhe ishin pak ma t’relaksuar që tash kanë me mujtë m’u kthy.

Po brengën ma t’madhe e kemi pasë te vllau i vogël, ai u duke që ka, është ma i traumatizuar prej krejt. Ai gjashtë vjeçarë, ka ndejtë n’atë frikë dy, dy, sa mujë i ra edhe diqysh e manifestojke me një agresivitet. E di që rreth tij diçka dikutojshin po n’anën tjetër krejt ka qenë veç me tregu çka kemi bo këto dy muj edhe n’fakt une kom ndëgjua edhe unë, unë jom ndi keq që s’kom qenë aty. Ndoshta mendojshja që ndoshta shumë ma mirë t’kish qenë me ta se sa që kom qenë larg sado që ata më thonin që, “Shumë ma mirë që bile ti nuk je”, por tërë kohën, jo s’i kom pasë aq prindët n’kokë sa motrën dhe vllaun që ishin shumë ma të vegjël se une. Ata nuk mujshja me i imagjinu t’u ndejtë e t’u i kalu edhe akoma kur e kujtoj atë kohë e kom një, nuk di m’kthehen disa emocione që s’du as m’i përmend, as m’i, me i kujtu.

Aurela Kadriu: Qysh pat’ ndodhë që pate shku në Austri, a ka qenë...

Zana Nixha: Në Austri ke mujtë me apliku në fakultet, universiteti ka qenë pa pagesë në fakt. Je pranuar, ka mujtë me t’u pranuar naj provim që e ki dhanë, në fakt je dashtë me qenë i regjistruar në Universitetin të Prishtinës mandej ki mujtë me bo si transfer, shumica kanë shku n’këtë mënyrë. Je dashtë me siguru fjetjen vet, ushqimin vet, këta kam mujtë prej prindërve. Ata që punonin në Shqipri një kohë t’gjatë por n’kohën kur, kur u bo lufta edhe s’kish mo kontakt, ti s’kishe mo as mjete se na u majshim vet e di që Austria e pat nda një fond burse për krejt studentët që kanë qenë atje. E kemi marrë një bursë mujore për me na mbajtë, se fillun mos me pasë me pagu studentat konviktin, me i përjashtu. Po pak u bo e madhe ajo punë se domethanë ata n’luftë s’kanë ku kthehen, s’kanë ku financohen edhe na po i qesim edhe prej... Kështu që, u vendos një bursë e mbaj n’mend që ja u kanë dhanë edhe boshnjakëve gjatë luftës kanë pasë vendosë mandej me vazhdu edhe për kosovarë.

Këta e mbaj n’mend, e mbaj n’mend që ka pasë një aktivizim shumë t’madh me mbledhë donacion kur e pashë që jom pa t’ardhuna fillova me punu edhe unë, edhe në Vienë jonë t’njoftun shitësit e biletave të koncertve të muzikës klasike edhe ata jonë të veshun me uniformë. Na u vesheshim me uniformë edhe u duheshim me i bindë turistat faktikisht me, me ble biletën edhe merrshim provizion prej biletës.

Edhe e mbaj n’mend n’atë kohë që kur e kuptojshin që jom e Kosovës, ka ardhë me një moment që edhe m’kanë sjellë para kështu me dorë, “Merri”. E di që edhe n’atë moment s’kom mujtë, sado që kështu ka qenë xhirologaria. Edhe po ka pasë shumë të tillë që kanë qenë t’gatshëm me ndihmu në qat’ aspekt mos t’flasim për ata që veç të rrethojshin pyetshin, “Tash, ku e ki familjen?” Për ta ishe diçka, po punon a nuk e din ku e ki familjen, je prej një zone t’luftës domethonë ka qenë mjaft njëfarë vetëdije e madhe. Sidomos amerikanët turista, ajo m’u pat’ dokë e çuditshme se amerikanët turista m’tregojshin që shumë amerikanë kanë vendosë sivjet mos me ardhë në Evropë n’pushime për shkak të luftës në Kosovë. Se për ta Evropa është aty, kur ka luftë në Kosovë domethonë në Evropë ka luftë edhe na s’po shkojmë prej atje, qeshtu këto mbaj mend prej, prej...

Pse kom vendosë m'u kthy? E kom pa që studimet gjatë zgjasin në Vienë, e kanë një sistem të tillë, nuk kanë kushte për vit t'parë, vit të dytë mundesh me dhanë një provim në vjet, mundesh me vazhdu. Domethanë, e kom pa që e kanë një sistem të tillë që studimet kanë me vazhdu gjatë edhe unë nuk pata shku me ndejtë dhetë vjet në Austri. Kisha qejf me, ndoshta kom mujtë edhe me, me e shpejtu, me shpejtu krejt procesin por mbas luftës në Kosovë, Kosova u bo senzacion. I ndëgjojsa në Universitetin e Prishtinës kishte, vinin arkitektë, studentë nga të gjitha vendet e, e rajonit mbanin seminare, ushtrime, kishin përvojë, shetitshin. Deri në momentin kur në Austri ndëgjoja që studentët prej Kosovës i kanë marrë me punu për byro projektuse si praktikë në asi sepse Kosova ka qenë atraksion u duhke me, edhe n'atë moment kom thonë ndoshta muj une me shfrytëzu këtë. Pse me ndejtë ktu kur në Kosovë po duket ma interesant krejt kjo punë?

Edhe kështu kom vendosë mu kthy sado që prind s'kanë qenë të pajtimit sepse ata vet kanë qenë profesorë në fakultet, unë po kthena në fakultet ku jonë ata, s'kishin qef me m'pasë studente (qeshë). Mendoj që kom bo mirë sepse edhe n'atë kohë ka pasë bash njëjtë kom, kom m'ka ra me udhëtu, me bashkpunu me shumë studentë të universiteteve të Britanisë, me pa, me kqyrë përvojat e shkollave të arkitekturës atje. Domethonë, ka qenë një, unë mendoj vendim i mirë sado që Austria kish ndikimin e vet me pa çka, si duhët me u orientu, si duhet me mësu, si duhet me...

Atje askush nuk të obligojke. Derisa në Kosovë gjithë fakultetin e kemi marrë pak si vazhdimësi të shkollës të mesme, thu se e ki të obligushme me shku edhe me mësu kah fundi. Në Austri ish ajo dëshira e studentit me nxjerrë sa ma shumë, me mësu sa ma shumë prej profesorit edhe prej, prej çkado që literaturë ose krejt. Ata e lypnin, e kërkonin atë dije edhe mu mendoj prej Austrisë më mbet kjo që domethonë me vazhdu këtu me dashtë me ditë vet e jo me pritë çka po më japin univerziteti ose kjo shkollë që e kom.

Aurela Kadriu: Çka keni vazhdu mandej mas fakultetit, çka ka ndodhë?

Zana Nixha: Në fakt m'ka zgjatë nja, mandej jom angazhu, mandej kom mendu që me arkitekturë duhet veç me punu, është ma shumë si zanat duhesh me qenë domethonë pranë një arkitekti përvojën që e bon pranë një arkitekti me një grup projektus. Kështu që, kështu kom vazhdu, jom anagazhu tek arkitektë të tjerë ose mandej edhe tek prindët. Kom mendu që duhna m'i shfrytëzu prindët në qat' profesion edhe nëse muj me mësu diçka muj me mësu prej tyne. Edhe kom punu gjatë domethonë me ta. Vonë kom fillu mandej edhe kapak vetë se m'vyjke edhe ajo pavarësia me pa sa muj vetë me, me punu.

Megjithatë, nuk mendoj që është bash koha ma e mirë për arkitekturën në Kosovë momentalisht, edhe n'gjithë këtë periudhën pas sepse nuk ka një, një vlerësim të profesionit. Edhe për faj të arkitektëve por në përgjithësi shkollimi nuk ka licensime, nuk mundesh me, nuk i dallon kush çka osht' edhe... tani edhe me këtë sistemin e ri *bachelor*, mundësh në Kosovë me projektu çdokush domethonë... ka ra pak ai kriteri i të qenurit arkitekt, pothuajse çdokush mundet me qenë. Tregu e orienton pak a shumë çka kërkohet. Nuk kërkohet ai kreativiteti që ti e ki dëshirë me dhanë si, si arkitekt, akoma jo, ta shohim (qeshë).

Aurela Kadriu: Çka je t'u bo momentalisht, a jeni?

Zana Nixha: Punoj privat, domethonë kur ka projekte, varësisht çfarë projekte kom ato i boj. Domethonë, nuk është punë prej 9:00 deri në 4:00 por kur ka punë punohet intensivisht mandej mundesh me metë deri n'punën tjetër e kështu me... kështu osht' natyra e punës n'fakt.

Aurela Kadriu: Nëse nuk keni diçka me shtu po ma merr menja që e kemi përfundu edhe faleminderit shumë.

Zana Nixha: Jo (qeshë), s'ka përse. Faleminderit edhe prej jush.